



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.05.2023

Nr: 106

Ora: 14:20

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 28, DATË 12.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj Drejtuesve të Policive Bashkiake të bashkive:

Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Durrës, Krujë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Elbasan, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Berat, Poliçan, Krujë, Pogradec, Maliq, Pustec, Kolonjë, Gjirokastrë, Dropull, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj,



Tepelenë, Selenicë, Himarë, Finiq, Sarandë, Konispol, Lezhë, Mirditë, Fier, Lushnje, Patos, Roskovec, Mallakastër, Skrapar, Fushë Arrëz, Cërrik, Kukës, Delvinë, Has, Libohovë, Vlorë, Kuçovë, Shkodër, Vau Dejës, Devoll, Divjakë.

BAZË LIGJORE:

Nenet 19, pika 1, shkronja “c” dhe 21, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni ndaj drejtuesve të Policive Bashkiake të 57 bashkive, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 28 regj., datë 12.05.2023. Në mbledhjen e datës 12.05.2023, ora 14:20, pas relatimit të z. Elvis Çefa, u konstatua se kërkesa nr.28 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 28, datë 12.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 15.05.2023, ora 12:30.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar